

2. Nuk ka shkelur kodin e etikës apo standardet e sjelljes profesionale, përveç nëse një dënim i tillë është ndryshuar nga një gjykatë ose organi tjetër i ankesave;
3. Nuk ka përgjegjësi me materiale nën çfarëdo detyrimi;
4. Nuk ka qenë në post menaxhues të ndonjë kompanie që ka falimentuar gjatë dhjetë (10) viteve të fundit.

Kandidati nuk mund të zgjidhet anëtar në Bordin e NP-së nëse:

1. Aktualisht është zyrtar (në kuptim të nenit 21 të Ligjit për Ndërmarrje Publike) menaxher i ndërmarrjes përkatëse, ose cilëndo nga filialet e saj;
2. Ka shërbyer si menaxher i ndërmarrjes publike përkatëse, ose cilëndo nga filialet e saj brenda pesë (5) viteve të kaluara;
3. Aktualisht ka ose gjatë tri (3) viteve të kaluara ka pasur çfarëdo marrëdhënie materiale afariste (përveç si konsumator individual i shërbimeve të ndërmarrjes publike) me ndërmarrjen publike përkatëse ose cilën do nga filialet, qoftë në mënyrë të drejtpërdrejtë dhe të tërthortë;
4. Është aksionar, drejtor ose zyrtar në një shoqëri tregtare ose person tjetër juridik, i cili ka marrëdhënie materiale afariste me ndërmarrjen publike përkatëse;
5. Pranon ose ka pranuar brenda tri (3) viteve të kaluara kompensimin shtesë nga ndërmarrja publike përkatëse, ose nga cila do nga filialet e saj (përveç honorarit të drejtorit ose kompensimin stimulus të përcaktuar me nenin 20 të Ligjit për Ndërmarrje Publike, ose është anëtar në skemën pensionale të ndërmarrjes publike ose të cilës do filialet e saja);
6. Përfaqëson një aksionar i cili posedon mbi dhjetë (10%) të aksioneve votuese në ndërmarrjen publike përkatëse;
7. Ka shërbyer në Bordin e drejtorëve të ndërmarrjes publike përkatëse, më shumë se nëntë (9) vite nga data e parë e zgjedhjes së tij;
8. Është i afërt i shkallës së tretë (siç është konstatuar në përputhje me përkufizimin e interesit financiar në nenin 2 të Ligjit për Ndërmarrje Publike) i cili do person që i takon cilës do nga kategoritë e sipërpërmendura;
9. Është zyrtar, drejtor ose aksionar, ose ka një interes financiar në një shoqëri tregtare që konkurren me ndërmarrjen, ose është menaxher i lartë zyrtar, drejtor ose aksionar (i cili posedon më shumë se dy përqind (2%) të të drejtave të votimit), ose ka një interes të konsiderueshëm financiar në cilëndo nga shoqëritë tregtare që konkurrojnë në ndërmarrjen;
10. Është, ose në çfarëdo kohe gjatë periudhës tridhjetë e gjashtë (36) mujore para datës së aplikimit ka qenë zyrtar i zgjedhur, i emëruar politik ose bartës i një posti udhëheqës ose vendimmartës në parti politike;

11. Ka çfarëdo konflikti të interesit që për nga natyra, do të shkaktonte që ky person të mos jetë në gjendje që në mënyrë efektive, me besnikëri, në mënyrë të paanshme dhe objektive t'i përmbushë detyrat e tij përgjegjëse ndaj aksionarëve dhe ndërmarrjes publike.

Procedura e Konkursit

Kandidatët për anëtarë të Drejtorëve të NP, duhet t'i dorëzojnë provat e mëposhtme:

- CV-në
- Letër motivimi
- Deklaratën nën Betim
- Dëshminë mbi përvojën e punës
- Certifikatën që nuk është nën hetime nga Gjykata Kompetente
- Kopjen e Letërnjoftimit

Aplikuesi duhet të plotësoj deklaratën nën betim, me të cilën deklaron se i përmbushë kushtet e kualifikimit pavarësisht nga përgaditja profesionale. Çdo përgënjeshttrim material, qoftë i qëllimshëm ose nga neglizhenca, ose ndryshimi material nga informatat e dhëna në deklaratën e sipërme përmendura, do të rezultojë me diskualifikimin e menjëhershëm.

Data e shpalljes së Konkursit nga data 11.08.2026 deri me datë 11.09.2026

Aplikantët e interesuar kërkesën për aplikim me dokumentacionet përcjellëse duhet ti dorëzojnë në zyrën e arkivit të komunës së Fushë-Kosovës nga data deri më datë çdo ditë pune nga ora 9 deri në orën 15h.

Aplikacioni dhe deklarata nën betim mund të shkarkohet në ueb-faqen e komunës së Fushë-Kosovës, ose mund të marrin fizikisht në zyrën e arkivit të komunës.

Konkursi është i hapur 30 ditë kalendarike nga dita e publikimit.

Kryesuesi i Aksionarëve

Izja Mjeku

